

**Nr. Prot.040/B/19**

## **VENDIMI Nr. 1367**

**Për**

### **Miratimin e 'Rregullores për Autorizime të Përgjithëshme për ofrimin e shërbimeve postare'**

Në mbështetje të nenit 4 paragrafi 1), nenit 7 paragrafi 2.1) dhe paragrafi 2.2), nenit 16 paragrafi 1), paragrafi 2) dhe paragrafi 3.1), nenit 20, dhe nenit 21 dhe 22, të Ligjit Nr. 06/L-38, për Shërbime Postare, (tutje referuar si - Ligji) nenit 79 paragrafi 1) dhe 2) të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike dhe nenit 13 paragrafi 1 dhe 5 i Statutit të Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP), Bordi i ARKEP i përbërë nga:

- 1) z. Kreshnik Gashi Kryetar i Bordit
- 2) z. Nijazi Ademja Anëtar i Bordit
- 3) z. Hazir Hajdari Anëtar i Bordit
- 4) z. Bahri Anadolli Anëtar i Bordit
- 5) z. Shqiprim Pula Anëtar i Bordit

në mbledhjen e 38-të, me rradhë të mbajtur më datë; 10.04.2019, pas shqyrtimit të materialeve dhe të përgatituar nga Sektori i Shërbimeve Postare, dhe DL, unanimisht mori këtë:

## **V E N D I M**

- I. Miratohet 'Rregullorja për Autorizime të Përgjithëshme për ofrimin e shërbimeve postare';
- II. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## **A R S Y E T I M**

Qëllimi i kësaj Rregullore, është vendosja e rregullave, përcaktimi i procedurave dhe kushteve të ofrimit të shërbimeve postare, në Republikën e Kosovës, nga ndërmarrësit që ofrojnë shërbime

postare nën regjimin e 'Autorizimit të Përgjithshëm', e që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar.

Ligji, respektivisht neni 7, paragrafi 2) përcaktonë se Autoriteti: *harton dhe miraton rregulloret në zbatim të këtij Ligji.*

Neni 8 përcakton se; *'Autoriteti gjatë procesit të hartimit të akteve nënligjore, të cilat kanë ndikim të ndjeshëm në tregun e shërbimeve postare, duhet të marrë dhe të vlerësojë mendimin e palëve të interesit, nëpërmjet konsultimit publik, sipas procedurave të përcaktuara nga Autoriteti'.*

Neni 21 paragrafi 2), i Ligjit përcakton se; *'Autoriteti me akt të veçantë miraton rregullat për dhënien e Autorizimit të përgjithshëm'.*

Duke pasur parasyshë atë që u tha më lartë, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Këshilla Juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e nxjerrjes së Vendimit.

**Prishtinë, 18/04/2019.**

## **Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

**Kreshnik Gashi**  
**Kryetar i Bordit**

### **Aktvendimi i dërgohet:**

- Operatorëve (ndërmarrësve) të cilët ofrojnë shërbimeve postare;
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik/Departamenti i Postë Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informative;
- Departamentit Ligjor (DL),
- Sektorit të Shërbimeve postare (SSHP),
- Arkivës së Autoritetit.